



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr.58/2019

Prishtinë, më 12.02.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Glauk Konjufca, Muharrem Nitaj, Duda Balje dhe deputeti Salih Zyba.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Liburn Aliu, Memli Krasniqi dhe Veton Berisha, anëtarë.

I ftuar: Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës: Kreshnik Ymeri – KDI, Moris Hyseni, Arbërore Bernica, Adem Ahmetaj, Shuqeri Musliu dhe Fidan Spahiu – MZHE, Vatra Qehaja – LVV, Besjana Bajrami – EkonomiaOnline, Enis Reçica – Klan Kosova dhe Kujtesa Bajrami – Fana – RTV21.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25 dhe 29.2.2019;
3. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Ndërmarrjeve Publike Qendrore për vitin 2017;
4. Diskutim për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 25 dhe 29.2.2019

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 25 dhe 29.01.2019, u miratuan pa vërejte.

3. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Ndërmarrjeve Publike Qendrore për vitin 2017

Kryetarja tha se Qeveria me vendimin nr.09/82 më 28.12.2018 ka aprovuar Raportin Vjetor për vitin 2017 mbi performancën e Ndërmarrjeve Publike Qendrore. Raporti është proceduar në Kuvend më 23.01.2019. Raporti iu është shpërndarë deputetëve më 30.01.2019. Në bazë të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Qeveria do t'i raportojë Kuvendit në bazë vjetore mbi performancën e këtyre autorizimeve dhe përgjegjësve, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.1 të këtij ligji. Qeveria do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit mbi mënyrën e menaxhimit të NP-ve Qendrore në interes të Republikës së Kosovës. Raporti përmban pjesën e parë ku përfshin sqarimin e përgjithshëm të performancës së sektorit të ndërmarrjeve publike, pjesën e dytë ku përfshin qeverisjen korporatave dhe pjesën e tretë ku përfshin performancën e secilës ndërmarrje publike qendrore veç e veç. Raporti në përgjithësi është i strukturuar mirë, është i ilustruar me tabela, diagrame dhe të dhëna statistikore. Në faqe 9, është paraqitur përkrahja financiare nga Qeveria për Ndërmarrjet Publike në formë të subvencioneve direkte dhe garantëve për investime, e që gjatë vitit 2017 kjo përkrahje është rreth 9.6 milionë euro, dhe rreth 5 milionë më pak sesa në vitin 2016. Çka po ndërmerr Qeveria apo ministria që performanca e ndërmarrjeve të përmirësohet, dhe të zvogëlohet edhe më tutje përkrahja financiare për ndërmarrjet publike? Në faqe 12, keni paraqitur punësimin në Ndërmarrjet Publike Qendrore, ku keni thënë se numri i të punësuarve gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin 2016, është rritur për 133 punëtorë. Cilat janë arsyet e rritjes së numrit të punëtorëve? Kjo rritje e numrit të punëtorëve a ka reflektuar në rritjen e performancës së ndërmarrjeve publike? Cili është roli i Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në raport me Ndërmarrjet publike lokale? Në faqe 20, performanca financiare për Telekomin e Kosovës është thënë se gjatë vitit 2017 e përmbylli vitin me një humbje vjetore prej 13.9 milionë euro. Pse po ndodh kjo rënie e performancës financiare të Telekomit të Kosovës? Çka po ndërmerr Qeveria që me ndalu rënien dhe me kthye në trend pozitiv? Në faqe 24 janë paraqitur sfidat e Postës së Kosovës. Çka po ndërmerret nga Qeveria dhe Ndërmarrja publike në fjalë për adresimin e atyre sfidave? A po ndikojnë Projektet kapitale në përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve publike?

Hykmete Bajrami tha se me duket shumë e paarsyeshme ta diskutojmë raportin e vitit 2017 kur ne jemi në vitin 2019 dhe s'ka kuptim të diskutohet për vitin 2017 kur ne kemi informata të rritjes së numrit të punëtorëve në ndërmarrjet publike në vitin 2018, të cilat operojnë me humbje. Besoj është shumë më e drejtë që të caktohet një datë në afat sa më të shpejtë ku mund të raportohet edhe për vitin 2018 dhe të bëhet raportimi për të dy vitet. Ky raport nuk ka shumë të dhëna, ka vetëm pasqyrën e të hyrave, shpenzimeve, pagave etj.

Lutfi Zharku tha se sipas ligjit brenda afatit prej 45 ditëve pas përfundimit të vitit, zyrtarët e ndërmarrjeve publike duhet të përgatisin raportin për bordin e drejtoreshave, që i bie më 15 shkurt. Propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të trajtohet për një mbledhje tjetër dhe të na sjellë raportin e menaxhmentit për bordin e drejtoreshave që ta shqyrtojmë, dhe përveç kësaj edhe raportin e kënaqëshmërisë dhe raportin financiar të detajuar të vitit 2018, që së paku ta kemi një pasqyrë për vitin që ka shkuar.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, me ligjin e ri për ndërmarrjet publike është paraparë që raportimi të bëhet çdo 6 muaj në Kuvend dhe çdo 3 muaj te ministri dhe jo një herë në vit siç është tani. Kemi kërkuar që të shtohen ndërmarrjet publike, të cilat do t'i nënshtrohen auditimit dhe duke pasur parasysh rrethanat nuk besoj që para muajit qershor të mund të kemi raportin për vitin 2018. Ajo që mund të bëjmë ne, është që gjendja financiare e pa audituar të bëhet shumë më herët, por sa është i besueshëm nuk mund të garantoj. Vlen të theksohet se në vitin 2018 janë katër ndërmarrje publike me shumë të audituara nga auditori i përgjithshëm. Zakonisht janë tri pozicione kyçe financiare që paraqiten në raport, janë të hyrat, shpenzimet si dhe asetet apo pasuritë e ndërmarrjes, krahasuar me vitin 2016, në vitin 2018 edhe pse ka pasur një rritje të punësimit rreth 1.3%, ndërmarrjet kanë përformuar më mirë. Në vitin 2016 kemi pasur vetëm pesë ndërmarrje me financa më pozitive, kurse në vitin 2018 kemi dhjetë ndërmarrje që kanë tregu se janë të vetë qëndrueshme. Janë pesë kompani që kanë operuar me humbje dhe këto janë, Telekom, Posta e Kosovës, Infracosi, Iberlepenci dhe KRU Anamorava. Subvencionet janë zvogëluar për rreth 5 milionë euro. Shqetësuese është zvogëlimi i investimeve kapitale ku hyjnë edhe shërbimet për qytetaret. Ne jemi në prag të një marrëveshje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të cilët do të na ndihmojnë në proces të zhvillimit të Telekomit duke i dhënë qasje në një kredi deri në 25 milionë euro, si dhe duke përgatitur terrenin për mundësinë e privatizimit të Telekomit. Qëllimi ynë është të ristrukturohet dhe të rregullohet gjendja në Telekom dhe pastaj të hapet mundësia për privatizim. Posta e Kosovës vazhdon të përballet me problemet e njëjta, nuk ka rritje të numrit të punësimit përveç zëvendësimit të numrit të punëtoreshave, vazhdon të jetë e varur nga qiraja që paguan Telekom, jemi në rinegocim në mes të Postes dhe Telekomit rreth qirasë. Pra, kjo është situata, 10 ndërmarrje janë të vetëqëndrueshme, kurse 6 janë në subvencionim dhe qëndrojnë mjaft keq.

Hykente Bajrami tha se me intereson ta dijë se kush do e marrë kredinë të cilën po e negocioni, Qeveria apo Telekom, dhe pse duhet vendimin për privatizim të Telekomit ta sjellë në Parlament për ta aprovuar, ku bazohet ky veprim?

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, tash fillon procedura e ristrukturimit të Telekomit. Telekom duhet të jetë në gjendje ta dëshmojë se do mund ta kthejë kredinë, pra kredia i jepet Telekomit, ka mundësi të kërkojë garancion nga Qeveria e Kosovës dhe besoj që kjo do të mund të sigurohet. Sa i përket privatizimit të Telekomit është Ligji për Ndërmarrjet Publike i cili e definon këtë çështje.

Glauk Konjufca tha se problemi me i madh sa i përket ndërmarrjeve publike është ideologjia qeverisëse, sepse ata mendojnë se këto ndërmarrje nuk funksionojnë dhe tani mundohen t'i bëjnë një zgjidhje. Keq menaxhimi dhe politizimi i ndërmarrjeve publike është shkatërrim i tyre, qeveria duhet sa më parë të heq ndikimin politik, ta bëjë planifikimin dhe organizimin me të mirë të këtyre ndërmarrjeve në mënyrë që të rritet vlera e tyre. Është e dhimbshme se qysh

Posta e Kosovës në vitin 2002-2003 është vlerësuar afro 800 milionë euro dhe tani vlera e saj ka rënë diku 6-7 herë me pak. Raporti i ndërmarrjeve publike duhet të përfshijë se si funksionojnë bordet, sa janë funksionale, përgjegjësia e tyre për ngritjen e performancës së ndërmarrjeve, kush e ka këtë përgjegjësi dhe ku po ngecin. Sa i përket kredisë, si është e mundur të merret kredi kur Qeveria planifikon privatizimin e Telekomit, kjo i bie të merret kredi sa për të zgjatur rrogat e militantëve partiakë.

Salih Zyba tha se meqë po flasim për një raport të vonuar, ne e dimë se raportimi i juaj z. ministër është i obliguar të ndodhë me datë të caktuar. Unë mendoj se duhet të sjellët raportin pavarësisht të dhënave të audituara apo jo, është mirë të caktohet një afat për të sjellë raportet e të dyja viteve.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, dua të sqaroj sa i përket kredisë që synohet të merret, kjo kredi do të ketë një plan investiv që hollësisht arsyeton marrjen e saj dhe investimin në teknologji që përmirëson shërbimin ndaj qytetareve. Kjo do të jetë shumë transparente dhe kjo kredi do të jepet për shpenzime kapitale. Sa i përket raporteve të pa audituara mund t'i sjellim edhe me herët, por nuk e di sa mund të jenë të besueshme pa qenë të audituara.

Hykmete Bajrami tha se kredia që synoni ta merreni duhet të kalojë përmes Kuvendit me 2/3 e votave të deputetëve. Kërkoj të sillët një plan investiv. Rreth instalimit të fibrave optikë, ka disa institucione që kanë investuar në fibra optikë, sikurse KOSTT-it, dhe është bërë duplikim i këtyre investimeve, a keni informata rreth kësaj çështje dhe a mund të merrni masa që të mos ketë duplikim në investime të paktën nga ana e institucioneve publike.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, sa i përket fibrave optikë KOSTT-i ka rrugë të tjera të investimeve në fibra optike, tani me Bankën Botërore kemi një plan investiv në fibra optikë në fshatrat e Kosovës, që është rrugë e ndarë prej investimeve të KOSTT-it në fibra optikë. Qëllimi është të arrihet mbulueshmëri në gjithë territorin e Kosovës, dhe nga ana e institucioneve shtetërore nuk ka duplikim të këtyre investimeve. Sa i përket sektorit privat ne nuk mund të kufizojmë se ku mund të investojnë ata.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Shqyrtimi i Raportit të performancës së Ndërmarrjeve Publike Qendrore për vitin 2017, do të shqyrtohet pasi që ministria të sjellë një informatë shtesë, ku duhet të përfshijë së paku: raportin e kënaqshmërisë së NP-ve; raportin e menaxhmentit për Bordin e NP-ve dhe raportet financiare të NP-ve.

4. Diskutim për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

Kryetarja tha se gjatë viteve 2017-2018 komisioni është përcaktuar ta mbikëqyrë Ligjin për Energjinë Elektrike, ka qenë i formuar grupi punues i udhëhequr nga deputeti Dardan Sejdiu, ky grup i punës nuk ka arritur të monitorojë këtë ligj, deputeti që udhëheq këtë grup punues ka kërkuar të vazhdojë punën në monitorim e këtij ligji. Dhe kemi mbështetjen e OJQ-së DPlus,

për monitorimin e një ligji, ata kanë dhënë disa propozime, por ne kemi parasysh se janë disa ligje të propozuara të cilat sapo kanë kaluar në Kuvend së fundmi dhe janë në fazën e nxjerrjes së akteve nënligjore dhe nuk mund të kemi monitorim të saktë në këtë fazë. Në mesin e propozimeve është edhe Ligji për Shërbimet, ku propozoj që ky ligj të monitorohet.

Salih Zyba propozoj që të monitorohet Ligji për mbrojtjen e konsumatorit sepse është mjaft aktual dhe kemi mjaft kërkesa nga qytetarët.

Në mungesë kuorumi, kjo çështje vendoset në mbledhjen e radhës.

5. Të Ndryshme Çështjet vijuese

Kryetarja njoftoi që më 19 dhe 20 shkurt, do të vizitojë Kosovën një delegacion i nivelit të lartë nga MCC Uashington. Kjo vizitë rrjedh si rezultat i avancimit të Kosovës në programin kompakt nga anëtarët e bordit të MCC-së. Delegacioni është i përberë nga znj. Karen Sessions, zv. Presidente e Kongresit dhe Çështjeve Publike, si dhe z. Jonathan Brooks, udhëheqës për Evropë, Azi, Pacifik dhe Amerike Latine, znj. Michelle Cigaurrista, dhe znj. Laura Allen nga MCC. Me këtë rast është mirë të caktohet një grup i deputetëve nga komisioni ynë që do t'i pres në takim, që do të mbahet më 20.2.2019 në orën 15:00.

Hykmete Bajrami tha se para se ta takojmë ekipin nga Korporatat e Sfidës së Mileniumit është me e rrugës ta takojmë ose të informohemi nga njësia jonë, e cila udhëhiqet nga Petrit Selimi dhe të kemi informacione në mënyrë që të jemi më të përgatitur për takim.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Kryetarja njoftoi edhe për kërkesën të cilën e ka dorëzuar kompania KIKA rreth mos kycjes në rrjet, e cila prodhon rreth 28 kilovat energji. Mendoj se është mirë të dalim t'i vizitojmë ZRRE-në, KOSTT-in dhe kompaninë në fjalë dhe të njoftohemi në detaje me problemin sepse kemi edhe kompani të tjera të cilat përballesh me të tilla probleme.

Hykmete Bajrami the se duhet të kërkojmë informata edhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për shkak të kuotave të lejuara.

Lutfi Zharku kërkoj që së pari të kemi një analizë profesionale për këtë çështje, e mandej të bëjmë vizitën apo t'i takojmë palët.

Propozimi u përkrah nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA